

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Qerim Ademaj e Zenel Leku anëtarë, në çështjen kontestimore të paditëses M.M. nga Prishtina, me vendbanim në lagjen “...” SU 7/4, hr.2, nr.3, të cilën e përfaqëson J.I. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” në Prishtinë, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.219/11 të dt.27.03.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 05.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e pjesërishtëm të ankesës së të paditurës, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 219/11 në pjesën që ka të bëjë me frikën e pësuar dhe shëmtimin, dhe gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” në Prishtinë, që paditëses M.M. për frikën e pësuar ti paguaj shumën prej 2000,00€, kurse për shëmtimin, shumën prej 1500,00 €, REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë për frikën e pësuar në lartësi prej 1000,00 €, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit, ankesa e të paditurës REFUZOHET si e pa bazuar dhe aktgjykimi i atakuar me ankesë në këtë pjesë VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.M. nga Prishtina dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” në Prishtinë që paditëses t’i paguaj në emër të kompensimit të dëmit jo material: shumën prej 3000 €, në emër të dhimbjeve fizike, shumën prej 3000 €, në emër të frikës 1500 €, për shëmtim trupor dhe 4000 € për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor gjithsej në shumë prej 11.500 €, të gjitha me kamatë siç i paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar, të afatizuar mbi 12 muaj, të llogaritura nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagën definitive. Refuzohet si e pa bazë pjesa e kërkesëpadisë, me të cilën paditësja ka kërkuar kompensimin e dëmit material për ndihmën dhe përkujdesje të huaj në shumën prej 100 € dhe 300 € për ushqim të përforcuar. Detyrohet e padita që palës paditëse në afatin kohor prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme të parave prej 803 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar apo jo të plot të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të prish aktgjykimi e gjykatës së shkallës së parë, dhe çështja të kthehet në rigjykim për rivendosje meritore.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja me padi ka kërkuar që të miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.M. nga Prishtina, detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” në

Prishtinë, që paditëses për lëndimet e renda trupore, të pësuar në fatkeqësi të komunikacionit më datë 13.01.2011 në rrugën "Luan Haradinaj" në Prishtinë, nga autobusi urban "Heunez", me targa ... i siguruar te e paditura, t'i paguajë dhe atë: për dhimbje fizike, shumë prej 1200 €, për frikë, shumë prej 1000 €, për shëmtim trupor, shumë prej 1200 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 1100 €, për ndihmën e huaj, shumë prej 200 €, për ushqim të përforcuar, shumë prej 200 €, për shpenzime material gjate shërimit, shumë prej 100 €, gjithsejtë 5000 €, të gjitha këto me kamat, si në mjetet pa destinim të caktuar të afatizuara në bankë mbi 1 vit, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e gjerë në pagesën përfundimtare dhe gjitha shpenzimet e procedurës. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Në pretendimet ankimore të të paditurës është theksuar se shumata e gjykuar janë të larta dhe nuk përputhen me kriteret e zhdëmtimit dhe praktikën e gjykatave të vendit. Lidhur me kërkesëpadinë, e paditura në pretendimet e saj ankimore ka kundërshtuar pasi që është bërë tejkalimi i kërkesëpadisë me ç'rast është dyfishuar shuma mbi atë maksimalen e kriterëve të kompanive të sigurimeve në Kosovë.

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të paditurës lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore sa i përket pjesës vërtetuese të dispozitivit të aktgjykimit nuk qëndrojnë pasi nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore. Kolegji vlerëson se aktgjykimi i atakuar për këtë pjesë nuk përmban shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 182 par.2 të LPK-së për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kolegji i gjykatës së shkallës së dytë nuk i akcepton për faktin se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë dhe në masë të plotë. Megjithatë, kolegji vlerëson se në pjesën për të cilën është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, në këtë pjesë në mënyrë të gabuar është bërë zbatimi i të drejtës materiale. Kjo për shkakun se lartësia e shumave të gjykuara është në disproporcion me mënyrën e kompensimit dhe praktikën e deritanishme në këto çështje të kompensimit të dëmit. Për këto arsye edhe Kolegji i Gjykatës së Apelit ka vendosur që të miratojë pjesërisht ankesën e të paditurës, dhe që të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në pjesën që ka të bëjë me frikën e pësuar. Lidhur me shëmtimin, gjykata e shkallës së dytë e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë konform nenit 201 pika e) të LPK, pasi që pala paditëse ka kërkuar shumë prej 1500,00€, kurse gjykata e shkallës së parë i ka akorduar shumë prej 4000,00 €.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1, pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3247/14 me datë 05.10.2017

Kryetari i Kolegjit-Gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj